



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 70

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.520, datë 1.8. 2003	Për miratimin e ndryshimit të formës së organizimit dhe të statutit të qendrës “Ecat Tirana” dhe për kontributin e Qeverisë shqiptare për këtë qendër.....	3149
Vendim i KM nr.522, datë 1.8.2003	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2003, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, 2003.....	3154
Vendim i KM nr.531, datë 1.8.2003	Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile.....	3155
Vendim i KM nr.532, datë 1.8.2003	Për përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile.....	3159
Vendim i KM nr.533, datë 1.8.2003	Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile	3160
Vendim i KM nr.534, datë 1.8.2003	Për miratimin e fletës së bllokut të procesverbalit të konstatimit të shkeljes nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH).....	3162

Vendim i KM nr.535, datë 1.8.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, që transferohen në pronësi të komunës Qendër,Skrapar	3164
Vendim i KM nr.536, datë 1.8.2003	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Korçës.....	3165
Vendim i KM Nr.539, datë 1.8.2003	Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë.....	3166
Vendim i KM nr.540, datë 1.8.2003	Për kuotën e pranimi në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, për vitin akademik 2003-2004.....	3166
Vendim i KM nr.541, datë 1.8.2003	Për kalimin në administrim të Ministrisë së Rendit Publik të gjashtë objekteve dhe të truallit funksional të tyre, të ish-brigadës së këmbësorisë, në Shijak.....	3166
Vendim i KM nr.544, datë 1.8.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.624, datë 21.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të Palës shqiptare, pjesëmarrëse në Forcën Shumëkombëshe të Europës Juglindore dhe të drejtat e ushtarakëve aktivë, pjesëmarrës në këtë forcë”, i ndryshuar.....	3167
Vendim i KM nr.547, datë 1.8.2003	Për miratimin e Protokollit shtesë të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunim në luftën kundër krimit, në veçanti kundër formave të organizuara të tij.....	3168
Vendim i KM nr.550, datë 1.8.2003	Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile.....	3171
Vendim i GJK nr.22, datë 25.7.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1215, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	3172
Vendim i GJK nr.23, datë 25.7.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.523, datë 3.5.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.512, datë 3.5.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	3174
Vendim i GJK nr.24, datë 30.7.2003	Me objekt shfuqizimin e nenit 375 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, si antikushtetues... ..	3177
Vendim i GJK nr.25, datë 30.7.2003	Me objekt shfuqizimin e nenit 437 pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 483 paragrafi i dytë dhe pjesërisht paragrafi i tretë të Kodit të Procedurës Civile, si antikushtetuese	3180

V E N D I M
Nr.520, datë 1.8. 2003

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FORMËS SË ORGANIZIMIT DHE TË STATUTIT
TË QENDRËS “ECAT TIRANA” DHE PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE
PËR KËTË QENDËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 e 42 të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe të nenit 54 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të formës së organizimit të “ECAT Tirana”, nga fondacion në qendër, si organ këshillimor i Ministrisë së Mjedisit, për hartimin dhe realizimin e projekteve dhe të programeve të ndryshme për administrimin e mjedisit, si dhe miratimin e statutit të qendrës, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kontributi i Qeverisë shqiptare si bashkëthemeluese e “ECAT Tirana”, duke filluar nga viti 2003 e në vazhdim, të jetë 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë në vit, i cili të përballohet nga buxheti vjetor i Ministrisë së Mjedisit, për mbulimin e shpenzimeve operative (qira, drita, ujë dhe telefon) të kësaj qendre.

3. Ministri i Mjedisit të caktojë përfaqësuesin e Qeverisë shqiptare në bordin e menaxhimit të “ECAT Tirana”.

4. Vendimi nr.399, datë 31.7.1995 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në fondin e pagave për Komitetin e Mbrojtjes së Mjedisit”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**STATUTI I ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE QENDRA PËR ADMINISTRIMIN DHE
TEKNOLOGJINË E MJEDISIT (ECAT-TIRANË)**

Hyrje

Në vitin 1993 Komisioni European vendosi të mbështesë ngritjen e një rrjeti qendrash për administrimin dhe teknologjinë e mjedisit (ECAT), duke synuar nxitjen e një zhvillimi të qëndrueshëm në vendet e Europës Qendrore e Lindore së bashku me zhvillimin social-ekonomik të ekonomisë së tregut. Ngritja e ECAT-eve duhet konsideruar si një shprehje e angazhimit të Komisionit European në zbatimin e planit të veprimit për mjedisin për Europën Qendrore e Lindore (EAP), një rezultat ky i Konferencës së Ministrave “Mjedisi për Europën”.

Në vitin 1995, Komiteti Shqiptar i Mbrojtjes së Mjedisit aprovoi partneritetin me Ministrinë e Bujqësisë, Ruajtjes së Natyrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Landit të Tyingenit në Gjermani, me Qendrën për Migrimin Ndërkombëtar-CIM (Ministria për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin) në Gjermani, si dhe me Bashkinë e qytetit të Ternit për të zbatuar një projekt të përbashkët bashkëpunimi, me mbështetjen e Bashkimit European LIFE-Third Countries, i cili do të synonte ngritjen e një qendre mjedisore për administrimin dhe teknologjinë në Tiranë, ECAT Tirana.

Mbi këtë statut, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, bazohet aktiviteti i Qendrës si një subjekt juridik.

Neni 1

Emri

1.01 Emri i Organizatës është “Qendra për administrimin dhe teknologjinë e mjedisit, Tiranë, më poshtë e referuar si ECAT Tirana.

1.02 Simboli i qendrës është një romb i vendosur në krahun e majtë të emërimit i përbërë me dy ngjyra; gjysma në ngjyrë lejla e vendosur në pjesën e sipërme dhe në ngjyrë jeshile pjesa e poshtme; në të spikatin tre tulipanë të bardhë. Në krahun tjetër vendoset në çdo rast flamuri i programit LIFE të Komisionit European. Përmasat e simbolit do të jenë në varësi të formatit ku vendoset.

2. Themeluesit

2.01 ECAT Tirana është themeluar në vitin 1995 nga personat juridikë të mëposhtëm:

- Komiteti Shqiptar për Mbrojtjen e Mjedisit (KMM);
- Komisioni European, DG Enviroment;
- Ministria e Bujqësisë, Ruajtjes së Natyrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Landit të Tyingenit, Gjermani.

- Qendra për Migrimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar (CIM), Gjermani;

- Bashkia e qytetit të Ternit, Itali.

2.02 Themeluesit ngritën Bordin e parë të drejtorëve, caktuan drejtorin ekzekutiv dhe përcaktuan mënyrën e administrimit të ECAT Tiranës, sikurse përcaktohet edhe në këtë statut.

Neni 3

Bazat ligjore

3.01 Aktivitetet e ECAT Tirana gjejnë bazën ligjore në legjislacionin aktual shqiptar të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, ligjin nr.8788, datë 7.5.2001, në këtë statut të pavarur dhe rregulloret e tij, si dhe në politikat dhe procedurat e ECAT Tiranës.

3.02 ECAT Tirana operon si një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare, e paanshme dhe jofetare. ECAT Tirana nuk është krijuar për fitime dhe asnjë pjesë e të ardhurave neto ose aseteve të saj mund të shkojnë për përfitimin e ndonjë personi privat apo ligjor.

Neni 4

Misioni

4.01 Misioni i ECAT Tiranës është të veprojë si një strukturë konsultative në fushën e mbrojtjes së mjedisit, administrimit të tij dhe aplikimit të teknologjisë bashkëkohore mjedisore, përfshi trajnime dhe asistencë teknike për të rritur mbrojtjen dhe përmirësuar mjedisin në Republikën e Shqipërisë:

- duke identifikuar, përgatitur, zhvilluar dhe zbatuar projekte ose programe në fushën e mjedisit, duke punuar në partneritet për zbatimin e këtyre projekteve ose programeve;

- duke asistuar autoritetet kombëtare dhe lokale për të përcaktuar shpërndarjen sa më efektive të burimeve financiare për veprimtaritë mjedisore, projektet dhe programet dhe të këshillojë për mundësitë e sigurimit të burimeve financiare;

- duke lehtësuar fluksin e informacionit mjedisor, duke punuar për zhvillimin e politikave, rregulloreve dhe standardeve mjedisore, që janë në harmoni me ato të Bashkimit European;

- duke shpërndarë, zhvilluar dhe zbatuar metodat e duhura administrative dhe teknologjike për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit; organizuar trajnime për autoritetet lokale, zhvilluar projekte dhe programe që synojnë promovimin e ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor të publikut;

- duke promovuar ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave mjedisore qeveritare dhe joqeveritare, institucioneve shkencore dhe kompanive industriale qofshin shtetërore, private, lokale ose ndërkombëtare;

- duke siguruar mbështetje financiare dhe krijuar iniciativa për të vendosur marrëdhënie pune brenda dhe ndërmjet sektorit joqeveritar dhe sektorëve të tjerë, duke përfshirë këtu qeverinë, median, biznesin dhe publikun e gjerë;

- duke siguruar mbështetjen përmes granteve financiare ndaj organizatave të regjistruara

jofitimprurëse shqiptare për aktivitetet e tyre jofitimprurëse;

- duke krijuar lehtësira për kërkime, gjetjen e burimeve dhe rritjen e organizimit të organizatave jofitimprurëse në aktivitetet e tyre jofitimprurëse, si dhe duke u angazhuar në sigurimin e kontributeve dhe financimeve që gjenerojnë të ardhura, me qëllim mbështetjen e punës së ECAT Tiranës në synimet jofitimprurëse.

Neni 5

Territori dhe vendodhja

5.01 ECAT Tirana i ka zyrat në Tiranë, Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë Shqipërinë. Zyrat e ECAT Tiranës ndodhen në rrugën “Abdyl Frashëri” P.16, Sh.6, Ap.53 Tiranë, Shqipëri.

5.02 Me vendim të Bordit të drejtorëve, ECAT Tirana mund të ngrejë dhe të mbajë zyra të tjera për zhvillimin e aktiviteteve në përputhje me misionin e saj, siç thuhet në nenin 4.

Neni 6

Struktura organizative

Bordi i drejtorëve

6.01 Bordi i drejtorëve, i themeluar në përputhje me statutin, do të drejtojë ECAT Tiranën për të siguruar që organizata të ndjekë dhe të plotësojë misionin e saj.

6.02 Bordi i drejtorëve është i përbërë nga shtatë anëtarë sipas këtij përfaqësimi:

- Ministria e Mjedisit, Shqipëri: një anëtar

- Komisioni European, DG. Environmental: një anëtar

- Ministria e Bujqësisë, Ruajtjes së Natyrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Landit të Turingenit, Gjermani: një anëtar.

- Qendra për Migrimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar (CIM), Gjermani: një anëtar.

- Bashkia e qytetit të Ternit, Itali: një anëtar.

- OJF-të për mjedisin: një anëtar.

6.03 Anëtarët e Bordit të drejtorëve veprojnë si vullnetarë duke shërbyer pa shpërblim. ECAT Tirana mund të rimbursojë drejtorët për kostot e udhëtimit, që lidhen me to kur bëhen për ECAT Tiranën ose për të zbatuar programe të ECAT Tiranës dhe në përputhje me politikat dhe procedurat e vendosura të organizatës.

- Bordi i drejtorëve është strukturë vendimmarrëse. Anëtarët e Bordit të drejtorëve duhet të zgjidhen për të shërbyer për një periudhë prej 24 muajsh dhe mund të rizgjidhen në përputhje me rregullat.

7. Kompetencat e Bordit të drejtorëve

7.01 Bordi i drejtorëve qeveris ECAT Tiranën. Bordi përcakton dhe siguron plotësimin e qëllimeve afatshkutra, afatmesme dhe afatgjata të organizatës dhe të gjithë programit të ECAT Tiranës.

7.02 Përveç rregullave në këtë statut, Bordi përcakton mënyrën sipas të cilës ai funksionon si bord, nëpërmjet rregulloreve, politikave dhe procedurave të vendosura nga ky Bord.

7.03 Bordi i drejtorëve ka kompetencën të caktojë ose të ndërpresë kontratën me drejtorin ekzekutiv. Kontrata e drejtorit ekzekutiv mund të ndërpritet në rastin kur:

- nga drejtori ekzekutiv kryhen veprime të tilla që kompromentojnë interesat e ECAT Tiranës në çfarëdo lloj mënyre.

- detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj janë përcaktuar në këtë statut, në politikat dhe procedurat e tjera, si dhe në kontratën e tij/saj.

7.04 Bordi i drejtorëve përcakton politikën fiskale të ECAT Tiranës. Bordi i drejtorëve, anëtarët e vendosur të bordit ose zyrtarët siç përcaktohet në rregullore mbikëqyrin menaxhimin dhe administrimin e të gjitha materialeve dhe burimeve financiare të organizatës. Kjo mbikëqyrje e menaxhimit financiar të ECAT Tiranës bazohet në raportimet e drejtorit ekzekutiv të ECAT Tiranës, si dhe raportet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme të saj.

7.05 Bordi i drejtorëve punon vazhdimisht për sigurimin e burimeve financiare dhe materiale për të bërë të mundur që ECAT Tirana të vazhdojë dhe të zgjerojë aktivitetin e saj. Bordi i drejtorëve

dhe drejtori ekzekutiv do të përcaktojnë prioritetet e projekteve. Drejtori ekzekutiv do të përcaktojë prioritetet e projekteve.

7.06 Vendimet merren gjatë mbledhjeve të zakonshme të Bordit të drejtorëve (katër herë në vit), si dhe në mbledhjet e jashtëzakonshme. Vendimet merren me votë të hapur, përveç rasteve kur zgjidhen anëtarët, si dhe ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që kërkon fshehtësinë e votës siç parashikohet në rregullore.

7.07 Bordi i drejtorëve vlerëson dhe parashikon ecurinë e punës së drejtorit ekzekutiv. Ky Bord kujdeset që politikat e personelit p.sh. marrja në punë, mbikëqyrja dhe ecuria e punës së të punësuarve të kryen në përputhje me procedurat e vendosura për këtë qëllim nga Bordi.

Neni 8

Kryetari i Bordit

8.01 Ministri i Mjedisit është Kryetari i Bordit.

8.02 Bordi i drejtorëve në mbledhjen e tij të parë zgjedh funksionarët e tij nëpërmjet një procesi të hapur kandidimi dhe me votë të fshehtë.

8.03 Bordi i drejtorëve mund të krijojë komitete të përhershme dhe komitete të përkohshme. Komitetet e përhershme përbëhen nga anëtarë të Bordit të zgjedhur prej vetë Bordit. Komitetet e përkohshme mund të formohen prej Bordit të drejtorëve në rast se nevojitet dhe kohëzgjatja e funksionimit të tyre përcaktohet dhe me vendim të Bordit. Komitetet e përhershme dhe të përkohshme paraqesin projekt-vendimet e propozuara në Bordin e drejtorëve për apelim final. Komitetet e përhershme dhe të përkohshme kur janë të autorizuar të zbatojnë vendimet e marra prej Bordit ose ato të marra prej komiteteve nën autoritetin e deleguar prej Bordit dhe raportojnë para Bordit për zbatimin e tyre.

8.04 Mbledhjet e zakonshme të Bordit të drejtorëve mbahen 4 herë në vit ose siç mund të përcaktohen në rregulloret. Takimet e jashtëzakonshme të Bordit të drejtorëve mund të thirren nga Kryetari i Bordit ose me kërkesë të kryetarit ekzekutiv ose një grup prej të paktën 3 persona nga Bordi i drejtorëve. Lajmërimi i Bordit të drejtorëve për mbledhjet e bordit duhet bërë paraprakisht së bashku me justifikimet për rrethana të veçanta.

8.05 Një shumicë prej më shumë se 51% e anëtarëve të Bordit të paraqitur në mbledhje është e nevojshme për marrjen e vendimeve në mbledhjet e zakonshme ose ato të jashtëzakonshme. Vendimet merren me konsensus për përjashtim të çështjeve të veçanta, sikurse përcaktohet në rregullore dhe në mbledhjet ku zgjidhen oficerët, aprovohen planprogramet dhe buxhetet, formohen komitetet e përhershme ose kur bëhet ndonjë ndryshim në statut apo në rregullore, në të cilat në një shumicë prej më shumë se dy të tretat e anëtarëve të Bordit të paraqitur në mbledhje është e nevojshme për të marrë vendimin.

8.06 Kryetari i Bordit ka detyrat e mëposhtme:

- thërret dhe drejton mbledhjen e Bordit të drejtorëve;
- mbikëqyr dhe raporton mbi zbatimin e vendimeve të Bordit;
- rishikon me drejtorin ekzekutiv çështjet më me interes për Bordin e drejtorëve.

Neni 9

Detyrat e drejtorit ekzekutiv

9.01 Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të ECAT Tiranës.

Drejtori ekzekutiv ligjërisht përfaqëson ECAT Tiranën në lidhje me palët e treta. Çdo dokument që ka të bëjë me aktivitetet e ECAT Tiranës duhet të firmoset nga drejtori ekzekutiv. Programi i punës së ECAT Tiranës do të zbatohet nga stafi ekzekutiv i ECAT Tiranës nën supervizionin e drejtorit ekzekutiv në përputhje me statutin, rregulloret, politikat dhe procedurat ECAT Tiranës.

9.02 Përzgjedhja e stafit është përgjegjësia e drejtorit ekzekutiv. Bordi i drejtorëve duhet të vihet në dijeni në lidhje me përzgjedhjen e stafit ekzekutiv.

9.03 Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për organizimin dhe për përgatitjen e materialeve të mbledhjes së Bordit të drejtorëve. Drejtori ekzekutiv përgatit minutat e mbledhjes.

9.04 Drejtori ekzekutiv raporton rregullisht në Bord nëpërmjet raporteve të shkruara ose

gojore. Bordi i drejtorëve, me një shënim të arsyeshëm mund të kërkojë në çdo kohë informacion nga drejtori ekzekutiv për zbatimin e programeve dhe të aktiviteteve, si dhe për gjendjen financiare të ECAT Tiranës. Bordi i drejtorëve nuk duhet të ndërhyjë në punën e përditëshme të drejtorit ekzekutiv ose në veprimtarinë e ECAT Tiranës, por mund të adresojë çështje të supervizimit pas rishikimit në Bord dhe në përputhje me statutin, rregulloret politikat dhe procedurat e ECAT Tiranës.

9.05 Drejtori ekzekutiv në përputhje me statutin, rregulloret, politikat dhe procedurat e ECAT Tiranës, nën drejtimin e Bordit të drejtorëve, do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përditshme të ECAT Tiranës: zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të aprovuara nga Bordi i drejtorëve, administrimin e burimeve materiale dhe financiare, reduktimin, supervizimin, vlerësimin e efektshmërisë, adresimin e problemeve dhe përfundimin e kontratave të punësimit të personelit; përgatitjen e buxheteve dhe projekt propozimeve, përfaqësimin e ECAT Tiranës tek klientët, donatorët, qeveria dhe publiku, si dhe detyra të tjera të përcaktuara në kontratën e punës.

Neni 10

Punësimi në ECAT Tirana

10.1 ECAT Tirana mund të punësojë personel, të evidentuar nga kontratat e shkruara të punës, për administrimin e programeve dhe aktiviteteve të organizatës. ECAT Tirana mund të punësojë staf ekzekutiv trajnues, staf për mbështetje administrative dhe personel të ndonjë lloji tjetër, siç shihet e nevojshme brenda limiteve të buxhetit të ECAT Tiranës.

10.2 Përveç drejtorit ekzekutiv dhe të vullnetarëve, personeli tjetër, raporton tek drejtori ekzekutiv ose ndonjë person tjetër menaxhues, sikurse është nënvizuar në politikat procedurat dhe/ose kontratat individuale të punës.

10.3 Të drejtat dhe përfitimet e personelit mbrohen nga Kodi i Punës i Shqipërisë, legjislacioni përkatës shqiptar, si dhe nga rregulloret, politikat dhe procedurat e ECAT Tiranës.

10.4 Drejtori ekzekutiv duhet të firmosë kontratat e punonjësve. Paga e të gjithë punonjësve duhet të vendoset në përputhje me çmime të arsyeshme të tregut.

Neni 11

Mbyllja e veprimtarisë/shpërndarja e ECAT Tirana

11.01 Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve, ECAT Tirana mund të transformohet në një formë tjetër ligjore ose të bashkohet me ndonjë organizatë tjetër me qëllime të ngjashme.

11.02 ECAT Tirana mund të shpërbëhet vetëm në rastet e mëposhtme:

- nga vendimi unanim i anëtarëve të Bordit;

- nga vendimi përfundimtar i një gjykate kompetente për shpërbërjen e organizatës.

11.03 Në rastet kur ECAT Tirana shpërbëhet, Bordi i Drejtorëve vendos sistemimin e aseteve sipas këtij statuti, legjislacionit aktual shqiptar dhe marrëveshjet ndërmjet donatorëve. Një anëtar i Bordit ose pjesëtar i stafit në asnjë rast nuk mund që të marrë asete mbas shkrirjes së organizatës.

Neni 12

Amdimi i statutit

12.01 Vetëm Bordi i drejtorëve ka të drejtën të rishikojë dhe t'i bëjë ndryshime/modifikime statutit të ECAT Tiranës.

Neni 13

Gjuha zyrtare e statutit

13.01 Ky statut është përgatitur në gjuhën angleze dhe atë shqip. Në rastet e ndonjë keqkuptimi të ngritur në bazë të interpretimit të statutit, versioni anglisht i tij do të jetë versioni zyrtar i statutit.

13.02 Statuti u përgatit në katër kopje në secilën gjuhë. Origjinalet janë mbajtur në Gjykatën e Rrethit Tiranë, në noteri dhe në arkivën e ECAT Tiranës.

V E N D I M
Nr.522, datë 1.8.2003

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2003, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 12 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në buxhetin e miratuar për vitin 2003 t’i shtohet fondi prej 286 000 000 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, 2003.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontigjencës i vitit 2003, parashikuar për zgjedhjet vendore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.531, datë 1.8.2003

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SHËRBIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shërbimi i emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, funksionon përmes 3 strukturave bazë operative:

- a) strukturat monitoruese/njoftuese;
- b) strukturat vepruese, aktive;
- c) strukturat vepruese, mbështetëse.

2. Strukturat monitoruese/njoftuese përbëhen nga ministritë, institucionet dhe institucionet e varësisë, Instituti Hidrometeorologjik, Instituti Sizmik, Instituti i Fizikës Bërthamore, Instituti i Kërkimeve Veterinare, Instituti i Kërkimeve Ushqimore, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve.

3. Strukturat monitoruese/njoftuese, së bashku me zyrat dhe inspektorët e emergjencave civile në administratën e prefektit, të ngarkuarit me problemet e emergjencave civile në bashki dhe komunë, japin të dhëna të vazhdueshme pranë Qendrës kombëtare të emergjencave operacionale civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për parashikimin dhe ndodhjen e fenomeneve, të ngjarjeve dhe aksidenteve, që dëmtojnë ose rrezikojnë jetën normale të shtetasve në Republikën e Shqipërisë, si dhe në vendet e rajonit.

4. Strukturat vepruese, aktive përbëhen nga baza e mbrojtjes civile, Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit (SAR), si dhe njësitë e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa kryejnë detyra për përballimin e emergjencave civile, strukturat e Policisë së Shtetit, repartet e policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në qarqe, si dhe stacionet zjarrfikëse, të krijuara me ligj pranë objekteve me rëndësi ekonomike, shtetërore dhe joshetërore, shërbimi i ambulancës, shërbimi i urgjencës mjekësore, inspektoriati i kontrollit radiologjik dhe inspektoriati shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor, reparti i inspektim-shpëtimit të minierave, reparti i likuidimit të avarive të KESH sh.a., Policia Elektrike dhe reparti avaro-shpëtues dhe i kërkim-përpunimit të naftës.

5. Strukturat vepruese, aktive angazhohen menjëherë për përballimin e çdo situatë të krijuar nga faktorë të ndryshëm, që kërcënojnë jetën, pronën dhe veprimtarinë normale të shtetasve, sipas planeve të gatishmërisë dhe të veprimit për situata të emergjencave civile, të hartuara dhe të miratuara më parë.

6. Strukturat vepruese, mbështetëse janë: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, vrojtuesit, Policia Pyjore dhe ndërmarrjet rajonale të ujërave, ndërmarrjet rajonale të ujësjellës-kanalizimeve, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve urbane dhe strukturat e Policisë së Ndërtimit, ndërmarrjet rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve dhe grupet e eliminimit të avarive, të Telecom-it, strukturat e Policisë Tatimore dhe të Doganave, organizmat ndërkombëtarë dhe/ose jofitimprurës, që kanë lidhje me emergjencat civile, brenda ose jashtë vendit, grupet dhe individë vullnetarë, strukturat ndërkombëtare, të specializuara për ndihmë humanitare, si Kryqi i Kuq Shqiptar dhe OJF-të që veprojnë në vend.

7. Strukturat vepruese, mbështetëse planifikohen për ndërhyrje në situata emergjente dhe angazhohen në situatat e krijuara, në mbështetje të strukturave vepruese, aktive.

8. Me kërkesën e prefektit, në rastet kur shtrirja e një emergjence civile rritet në mënyrë të menjëhershme, pas njoftimit të drejtuesve të organeve qendrore, që kanë në varësi strukturat përkatëse, për përballimin e situatave mund të angazhohen strukturat vepruese mbështetëse, që veprojnë në territorin e qarkut, por që janë në varësi të drejtpërdrejtë të organeve qendrore.

9. Departamenti i planizimit dhe përballimit të emergjencave civile shërben si pikë kontakti, në nivel kombëtar, për të gjitha problemet që kanë lidhje me emergjencat civile si në kohë të qetë, edhe në kohë emergjence.

10. Qendra kombëtare operationale e emergjencave civile, në veçanti mban lidhje të vazhdueshme me Qendrën e bashkuar operationale të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendrën e informacionit të Ministrisë së Rendit Publik, si dhe me çdo pikë kontakti të organeve qendrore e vendore dhe me institutet dhe agjencitë që lidhen me emergjencat civile. Këto struktura kanë detyrime të ndërsjella për dhënien dhe marrjen e informacionit.

11. Ekipet dhe ndihmat, që vijnë nga shtete të tjera dhe strukturat ndërkombëtare të emergjencave civile, veprojnë në operationet e kërkim-shpëtimit dhe të ndihmës humanitare sipas standardeve dhe procedurave ndërkombëtare, konventave për dhënie ndihme në rastet e emergjencave civile, marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh dhe në përputhje me apelet e kërkesat që u bëhen nga strukturat përgjegjëse shtetërore.

12. Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe drejtuesi qendror i operationit, kur emergjencat civile kanë rritje të menjëhershme dhe kërcënuese, i kërkojnë Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Rendit Publik përdorimin e forcave të armatosura, të forcave të ndërhyrjes së shpejtë dhe speciale, në operationet për përballimin e emergjencave civile dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara.

13. Baza e mbrojtjes civile, njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe repartet speciale të Ministrisë së Rendit Publik, në operationet e shpëtimit dhe të riaftësimit drejtohen nga komandantët e tyre, sipas detyrave që u jepen nga drejtuesi i operationit.

14. Kur shtrirja ose ndikimet e një emergjence civile rriten në mënyrë të menjëhershme dhe bëhet e papërballueshme nga kapacitetet që ka qarku, prefekti i drejtohet Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, i cili i kërkon Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes ose Ministrit të Rendit Publik angazhimin e njësisë të forcave të armatosura dhe të forcave speciale të Ministrisë së Rendit Publik.

15. Në rast situatë emergjente, me kërkesë të kryetarit të bashkisë ose të komunës, prefekti cakton, pranë komisionit vendor për emergjencat civile të bashkisë ose komunës, një pjesë ose të

gjithë stafin e zyrës së emergjencave të administratës së tij.

16. Në rast të një fatkeqësie të menjëhershme, katastrofike, kryetari i bashkisë ose i komunës u drejtohet, drejtpërdrejt, për ndihmë të gjithë drejtuesve të strukturave të sistemit të emergjencave civile, që veprojnë në territorin e tij ose të atyre fqinjë, njofton menjëherë prefektin dhe Qendrën kombëtare operacionale në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

17. Në varësi të tipit dhe të përmasave të fatkeqësisë, Qendra kombëtare operacionale e emergjencave civile njofton strukturat e shërbimit të emergjencave civile të çdo niveli, të cilat pas këtij njoftimi, vihen në gjendje gatishmërie.

18. Të gjitha efektivat e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, për kohën që kryejnë detyra në përballimin e këtyre emergjencave, krahas stemës së institucionit përkatës, mbajnë dhe stemën e shërbimit të emergjencave civile të Republikës së Shqipërisë, e cila miratohet me këtë vendim dhe përdoret në uniformat e strukturave të shërbimit të emergjencave civile dhe në shkresat zyrtare.

19. Stema e shërbimit të emergjencave civile është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

20. 26 marsi, dita e miratimit të ligjit “Për emergjencat civile” njihet si dita e shërbimit të emergjencave civile.

21. Strukturat e drejtimit operacional të emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, janë pjesë e strukturave kombëtare të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.

22. Në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile, drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, deri në caktimin e drejtuesit të operacionit, e merr komandanti i stacionit zjarrfikës më të afërt. Në të gjitha rastet, veprimet operacionale kryhen në zbatim të manualit “Mbrotjtja civile”, i cili miratohet nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit.

23. Kur shpallet gjendja e emergjencave civile, për drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, caktohen drejtuesit e operacioneve në nivelet e mëposhtme:

a) Drejtuesi qendror i operacionit, i cili emërohet nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.

b) Drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i cili emërohet nga prefekti.

c) Drejtuesi i operacioneve në nivel bashkie dhe komune, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës.

ç) Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale të tyre.

24. Drejtuesi qendror i operacionit kryhen këto detyra:

a) Vepron sipas udhëzimeve që merr nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile dhe raporton përpara këtij komiteti, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky Komitet.

b) Menaxhon situatën dhe strukturat e shërbimit operacional të emergjencave civile në nivel qendror, në zbatim të Planit Kombëtar për përballimin e Emergjencave Civile.

c) Vendos lidhje të drejtpërdrejta me Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe i kërkon atij raporte periodike e përmblledhëse për situatën.

ç) Kërkon nga drejtuesit e operacioneve dhe të strukturave të shërbimit të emergjencave civile të niveleve më të ulëta, zbatimin e detyrave për përballimin e emergjencave civile.

d) Bashkëpunon me drejtuesit e operacioneve dhe strukturat e shërbimit të emergjencave civile në bashki dhe komuna.

25. Drejtuesi i operacionit në nivel qarku kryen këto detyra:

a) Menaxhon situatën nëpërmjet drejtimit të strukturave operacionale të shërbimit të emergjencave civile, në zbatim të planeve të hartuara më parë për përballimin e emergjencave civile në nivel qarku.

b) Vepron sipas udhëzimeve që merr nga komisioni i bashkërendimit të veprimtarive për emergjencat civile në qark dhe raporton përpara këtij komisioni, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky komision.

c) Vendos lidhje të drejtpërdrejta me drejtuesin qendror të emergjencave civile pranë Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, me Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe dërgon raporte periodike e përmblledhëse për situatën.

ç) Bashkëpunon me drejtuesit operacionalë dhe me strukturat e shërbimit të emergjencave civile në bashki dhe komuna.

d) Bashkëpunon me grupe të shërbimit vullnetar të emergjencave civile dhe me organizma e institucione të huaja, të specializuara në përballimin e emergjencave civile, që ofrojnë ndihmë në territorin.

26. Drejtuesi i operacionit në bashki/komunë kryen këto detyra:

a) Zbaton udhëzimet e kryetarit të bashkisë/komunës, mban lidhje të vazhdueshme me zyrën e emergjencave civile të administratës së prefektit dhe me Qendrën kombëtare operacionale të emergjencave civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

b) Raporton dhe ndjek udhëzimet e Komisionit vendor për emergjencat civile dhe kërkon mbështetjen e këtij Komisioni.

c) Vepron sipas planeve të përballimit të emergjencave, të hartuara më parë dhe të miratuara në këshillin bashkiak ose komunal, të cilat janë pjesë e planit të emergjencave të qarkut.

ç) Në rast se situata përkeqësohet dhe me mundësitë e mjetet që zotëron nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë ose të komunës të kërkojë mbështetje nga bashkitë ose komunat fqinje dhe nga instancat më të larta shtetërore.

d) Bashkëvepron me grupe vullnetarësh, të specializuar për përballimin e emergjencave dhe me banorë, që shprehin dëshirën të përfshihen përkohësisht në strukturat e shërbimit të emergjencave civile të bashkisë/komunës.


27. Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale kryejnë detyrat dhe përgjigjen për zbatimin e planeve për përballimin e emergjencave civile, sipas niveleve përkatëse.

28. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizimit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, prefektët e qarqeve, institutet kërkimore dhe shkencore, organet e qeverisjes vendore, si dhe agjencitë e subjektet e ndryshme, që kanë lidhje me planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Stema e Sherbimit te Emergjencave Civile



V E N D I M
Nr.532, datë 1.8.2003

PËR PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË PLANIFIKIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001

“Për emergjencat civile” dhe të pikës I/1 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Departamenti i planifikimit dhe i përballimit të emergjencave civile është përgjegjës për:
 - a) bashkëpunimin me institucionet e tjera për hartimin dhe freskimin e Planit Kombëtar për Përballimin e Emergjencave Civile;
 - b) hartimin e planeve për plotësimin dhe freskimin e rezervave të emergjencave civile, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile;
 - c) menaxhimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe bashkërendimin e strukturave, shtetërore dhe joshtetërore që lidhen me to;
 - ç) përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e akteve nënligjore për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile;
 - d) organizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh, për problemet e emergjencave civile, mbrojtjen nga zjarri dhe të ndihmave humanitare.
2. Departamenti i planifikimit dhe i përballimit të emergjencave civile ka këto detyra:
 - a) Zbaton, së bashku me institucionet e tjera, politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planifikimit për përballimin e emergjencave civile, të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si dhe në krijimin, përdorimin dhe shpërndarjen e mallrave rezervë emergjente: ushqimore, materiale e monetare.
 - b) Bashkëpunon me institucionet dhe entet publike të vendit, për të bërë vlerësimin e situatave emergjente mbi të cilat bazohet Plani Kombëtar i Emergjencave Civile dhe organizon punën për freskimin e tij në mënyrë periodike.
 - c) Ndjek në vazhdimësi situatën e mbrojtjes nga zjarri dhe gjendjen e emergjencave civile në të gjithë territorin e vendit, në rajon dhe më gjerë dhe planifikon masa vepruese ndaj tyre.
 - ç) Planifikon fonde për studime nga entet publike për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.
 - d) Në çdo 6 muaj përgatit raport për gjendjen e përgjithshme të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile.
 - dh) I siguron Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat emergjente, për rreziqet që paraqesin, si dhe mundësitë për mbështetje materiale të operacioneve për përballimin e emergjencave civile.
 - e) Planifikon dhe përcakton rregullat e përdorimit të burimeve financiare e materiale, në rastet e emergjencave civile.
 - ë) Bashkërendon punën e institucioneve qendrore me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile.
 - f) Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e strukturave aktive dhe mbështetëse të shërbimit të emergjencave civile.
 - g) Kërkon të dhëna për përballimin e emergjencave civile, duke komunikuar drejtpërdrejt me strukturat e përhershme dhe të përkohshme të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror, në nivel qarku dhe bashkie e komune.
 - gj) Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile.
 - h) Lidh marrëveshje me shoqata dhe organizma, që ofrojnë asistencë për realizimin e detyrave të planit, për përballimin e emergjencave civile dhe për krijimin e rezervave.
 - i) Organizon dhe drejton konferenca, seminare dhe workshope për personelin e shërbimit të emergjencave në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
 - j) Përpunon dhe ndjek programet e edukimit publik dhe të trajnimit të strukturave shtetërore dhe joshtetërore, në fushën e mbrojtjes civile.
 - k) Udhëzon strukturat përgjegjëse për mënyrën e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të opinionit publik për emergjencat civile dhe mbrojtjen nga zjarri.
 - l) Bashkërendon për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe riaftësimin nga fatkeqësitë

natyrore ose nga fatkeqësi të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

ll) Kontrollon zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese për përballimin e rasteve të emergjencave civile dhe mbrojtjes nga zjarri pranë subjekteve shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit.

m) Kontrollon mënyrën e përdorimit të burimeve materiale dhe financiare që vihen në dispozicion nga Buxheti i Shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave civile për organet qendrore dhe vendore.

n) Kontrollon shpërndarjen dhe mënyrën e përdorimit të mallrave rezervë emergjente, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

nj) Organizon grupe ndërministrorë monitorimi për mënyrën e menaxhimit të sistemit të emergjencave civile.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave dhe ministritë e linjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.533, datë 1.8.2003

PËR PJESËMARRJEN E SHTETASVE NË PARANDALIMIN DHE PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 35 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të nenit 12 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prefekti i qarkut, nëpërmjet zyrave të gjendjeve civile në bashki dhe komuna, siguron të dhëna dhe mban evidencë për shtetasit në territorin e qarkut, me moshë nga 18 deri në 55 vjeç për gratë dhe deri në 60 vjeç për burrat.

2. Prefekti i qarkut, nëpërmjet qendrave të rekrutim-mobilizimit në qarqe, evidenton dhe siguron të dhëna për shtetasit, të cilët gjatë shërbimit ushtarak janë specializuar në shërbime të mbrojtjes civile, operacionet e kërkim-shpëtimit, repartet xheniere, mbrojtjen nga armët e shkatërrimit në masë, mbrojtjen nga zjarri, shërbimin shëndetësor, si dhe specialitete të tjera të nevojshme për përballimin e emergjencave civile.

3. Prefekti i qarkut, nëpërmjet drejtorive arsimore të rretheve, evidenton dhe siguron të dhëna për shtetasit, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë dhe janë specialistë të fushave përkatëse, si dhe planifikon përfshirjen e tyre në procesin e planifikimit, parandalimit dhe përballimit të emergjencave civile.

4. Në rastet e emergjencave civile, drejtuesi qendror i operacionit/drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i kërkon prefektit të qarkut angazhimin, sipas nevojave të shtetasve të aftë. Prefekti i qarkut, në bashkërendim me kryetarin e bashkisë/komunës, urdhëron aktivizimin e shtetasve dhe planifikon përfshirjen e tyre pranë strukturave operacionale, që veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e qarkut.

5. Kryetari i bashkisë/komunës, nëpërmjet zyrave të gjendjeve civile në bashki dhe komunë, siguron të dhëna dhe mban evidencë për shtetasit në territorin përkatës, me moshë nga 18 deri në 55 vjeç për gratë dhe deri 60 vjeç për burrat.

6. Kryetari i bashkisë/komunës, në rastet e emergjencave civile, me kërkesë të komisionit vendor të Emergjencave Civile në bashki/komunë, drejtuesit të operacioneve në nivel qarku, drejtuesit të operacioneve në nivel bashkie/komunë, në bashkërendim me prefektin urdhëron angazhimin, sipas nevojës të shtetasve të aftë në territorin përkatës të bashkisë/komunës dhe planifikon përfshirjen e tyre

pranë strukturave vendore ose strukturave të tjera operationale, që veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e prekur nga fatkeqësia.

7. Kur shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile mbi 8 orë në ditë dhe larg vendbanimit sipas rastit, prefekti i qarkut, kryetari i bashkisë/komunës, në bashkëpunim me strukturat operationale dhe shoqatat humanitare, ku shtetasi është angazhuar, e trajtojnë me ushqim dhe fjetje.

8. Asnjë drejtues operationi nuk mund të detyrojë shtetasin e angazhuar në operationet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, të ndërhyjë në situata dhe vende ku rrezikohet jeta e shtetasit, si dhe ku/kur kërkohet kualifikim i veçantë.

9. Në çdo rast kur me urdhër të prefektit, kryetarit të bashkisë/komunës, shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, atij i lëshohet dokument zyrtar, që vërteton angazhimin e tij në strukturën përkatëse.

10. Dokumenti zyrtar, që vërteton pjesëmarrjen e shtetasit në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, detyron punëdhënësin, qoftë ky dhe subjekt privat, të garantojë vendin e punës dhe pagesën e plotë.

Në rastet e aksidenteve, institucionet përkatëse plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për përfitim të pensionit të invaliditetit, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Për moszbatimin e urdhërit të prefektit të qarkut dhe të kryetarit të bashkisë/komunës për pjesëmarrje të shtetasve në përballimin e situatave emergjente, zbatohen dispozitat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Prefekti i qarkut, në bashkëpunim me qendrat e rekrutim-mobilizimit në qarqe, me drejtuesit e reparteve të forcave të armatosura në territorin e qarkut, me stacionin e PMNZSh-së dhe OJF-të, programon dhe realizon trajnimin e shtetasve për situatat e emergjencave civile.

13. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes, prefektët e qarqet dhe kryetarët e bashkive/komunave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.534, datë 1.8.2003

PËR MIRATIMIN E FLETËS SË BLOKUT TË PROCESVERBALIT TË KONSTATIMIT TË SHKELJES NGA POLICIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT (PMNZSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38 e 41 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e fletës së bllokut të procesverbalit të konstatimit të shkëljes (gjohë e menjëhershme) nga PMNZSH-ja, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Financave

për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Minisria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
Sektori i PMNZH Qarkut _____ Nr.serie. 000 000.
Nr.Regj_____



PROCES-VERBAL I KONSTATIMIT TË SHKELJES
(Gjobë e menjëhershme)

DEK I ARATË	SHKE I JE	PR ONËSIA	C BJEKTI	SH KEJËSI	DAT A. VENDI
Data _____					
muaji _____ viti _____ ora _____					
Rruga _____ vendi _____					
Objekti _____					
Unë _____ i _____ nënshkruari _____ konstatova					
që _____					
(Shkelësi _____ administrativ) Mbiemri _____					
Emri _____ Adresa _____					

Objekti _____ (tipi _____ i _____					
objektit) _____					

Pronësia _____ e _____					
objektit _____					
Emër _____					

Mbiemër _____

Adresa _____

Shkelja e konstatuar _____

Ka shkelur ligjin nr.8766, dt. 5.5.2001, nenin _____

Sepse _____

Deklaratë _____

Shkelësi administrativ deklaron: _____

Për shkeljet e sipërpërmendura vendosa:

Ta gjobisë me _____ (_____) lekë.

Kundravajtësi _____

Përpiluesi i procesverbalit _____

Shënim. Likuidimi i gjobës duhet bërë brenda 10 (ditëve) që vendimi merr formën e prerë. Pas kalimit të këtij afati, çdo ditë vonesë, paguhet 2 % kamatë deri në 30 ditë. Derdhja bëhet pranë zyrave përkatëse të agjentit kontrollues (pranë prefekturës), ku është kryer shkelja administrative.

Kundër konstatimit të shkeljes, shkelësi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

Modeli i procesverbalit duhet të jetë i plotësuar me treguesit përkatës të sektorit, të stacionit,

të inspektorit, të agjentit kontrollues, sipas normave të ligjit të PMNZSH.

V E N D I M
Nr.535, datë 1.8.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS QENDËR, SKRAPAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi të komunës Qendër, Skrapar, sipas tabelës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër, Skrapar, miratuar me vendimin nr.363, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Qendër, Skrapar”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe komuna Qendër, Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhje nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës
1-214	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit
218-254, 259, 261, 275	Kullota dhe pyje me interes vendor
492-503 (vetëm rrjeti terciar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (ujtje e kullim)
508-538, 540-542	Rrugë vendore të brendshme dhe komunale
543-562	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
563-565	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
566-586	Varrezat publike
587-597	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
604	Sistemi i largimit të ujërave të zeza

V E N D I M
Nr.536, datë 1.8.2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 17 të ligjit nr.8744, datë

22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprahe të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Korçës, sipas tabelës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprahe, sipas kërkesave të Këshillit Bashkiak të Korçës, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të kësaj Bashkie, miratuar me vendimin nr.365, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Korçës”.

2. Pronat me numër rendor inventari 666 dhe 667 të vazhdojnë të përdoren nga përdoruesit, në bazë të aktmarrëveshjeve ose të rregullimeve të tjera ligjore ndërmjet tyre dhe Bashkisë së Korçës.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhje nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës
28-52, 478	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive
54-78, 925, 927	Monumentet historike e kulturore dhe buste me interes vendor
79-451	Pronat që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile
519-563	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
572-601, 605, 609	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale
610-630, 632-634	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
637, 638	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit
685, 919-922	Troje dhe hapësira publike
686-875, 946	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike
877-918, 923-924, 929-935	Infrastrukturë vendore dhe shërbime publike.
926	Varrezat publike
928	Rrjeti i ndriçimit publik

V E N D I M Nr.539, datë 1.8.2003

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 të ligjit

nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë.
2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.540, datë 1.8.2003

PËR KUOTËN E PRANIMIT NË AKADEMINË USHTARAKE “SKËNDERBEJ”, PËR VITIN AKADEMIK 2003-2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, paragrafi i dytë të ligjit nr.8671, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- Kuota kryesore e pranimi në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, për vitin akademik 2003-2004, të jetë 65 (gjashtëdhjetë e pesë) studentë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.541, datë 1.8.2003

PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK TË GJASHTË OBJEKTEVE DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, TË ISH- BRIGADËS SË KËMBËSORISË, NË SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në administrim të Ministrisë së Rendit Publik, për nevoja të rajonit të policisë së Shijakut, të 6 objekteve, së bashku me truallin funksional të ish-brigadës së këmbëtorisë, në Shijak (reparti ushtarak 8800, Shijak), të cilat deri tani kanë qenë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Ministrisë së Rendit Publik i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’i japë në përdorim të tretët.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të bëjë kalimin në administrim të Ministrisë së Rendit

Publik të kësaj prone të paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Ministria e Rendit Publik të përballojë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.544, datë 1.8.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 624, DATË 21.12.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE NË FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE DHE TË DREJTAT E USHTARAKËVE AKTIVË, PJESËMARRËS NË KËTË FORCË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8544, datë 4.11.1999 “Për ratifikimin e marrëveshjes dhe protokollit shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore” dhe të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pjesën II të vendimit nr.624, datë 21.12.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shprehja “... me vendndodhje në Plovdiv, Bullgari ...”, zëvendësohet me “... në vendndodhjen e shtabit të brigadës...”.
2. Në pikën 11 shprehja “... për këtë shtet, Bullgarinë, ...” zëvendësohet me “... për shtetin ku është vendosur shtabi i brigadës ...”.
3. Në pikën 12 pas fjalës “... gaz ...” shtohen fjalët “... lavanderi dhe abonim në kabëll TV...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.547, datë 1.8.2003

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË TË MARRËVESHJES NDËRMJET
QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË
DETIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, NË VEÇANTI
KUNDËR FORMAVE TË ORGANIZUARA TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Protokollit shtesë të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunim në luftën kundër krimit, në veçanti kundër formave të organizuara të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL SHITESË
I MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN PËR LUFTËN NDAJ
KRIMIT, VEÇANËRISHT NDAJ FORMAVE TË ORGANIZUARA TË TIJ

Hyrje

Qeveritë e shteteve anëtare të BEDZ-it, Palë në këtë Protokoll shtesë, më poshtë të quajtura “Palët”:

sipas dispozitave të neneve 2, 4, 6 dhe pikës 10 të nenit 5 të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve të BEDZ-it, pjesëmarrëse në bashkëpunimin për luftën ndaj krimit, veçanërisht ndaj formave të tij të organizuara, firmosur në Kerkyra më 2 tetor 1998, më poshtë të quajtur Marrëveshja e “BEDZ-it”,

të ndërgjegjshëm për rolin dhe rëndësinë në rritje të nismave rajonale për bashkëpunim në fushën e luftës ndaj krimit;

duke theksuar vendosmërinë e tyre për të arritur përmes përpjekjeve të përbashkëta një përmirësim të qëndrueshëm për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes së BEDZ-it;

me qëllim që të sigurohet niveli i duhur i koordinimit ndërmjet autoriteteve të shteteve anëtare,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Krijimi i një Rrjeti oficerësh ndërlidhës

Palët do të ngrenë Rrjetin e oficerëve ndërlidhës të BEDZ-it për luftën ndaj krimit, më poshtë i quajtur “Rrjeti”, i cili do të konsistojë në oficerë ndërlidhës të caktuar nga shtetet anëtare si përfaqësuese të tyre.

Neni 2

Objektivat

Objektivat e Rrjetit janë si më poshtë:

1. Të përforcojë bashkëpunimin në fushën e kontrollit ndaj krimit dhe të sigurojë koordinim dhe ndërveprim ndërmjet organeve kompetente të Palëve.
2. Të ngrejë një rrjet për shkëmbim informacioni ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit të

shteteve anëtare për të luftuar me efikasitet krimin dhe kriminelët, në përputhje me Marrëveshjen e BEDZ-it.

Neni 3

Detyrat dhe funksionet

Oficerët ndërlidhës të Rrjetit kanë detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

1. Të dërgojnë në vendet e tyre përkatëse kërkesa të paraqitura nga oficerë të tjerë ndërlidhës për raste urgjente për një ditë, ndërsa për raste të tjera për tre ditë, në përputhje me dispozitat e nenit 9 të Marrëveshjes së BEDZ-it.

2. T'u dërgojnë Palëve me kërkesën e tyre informacionin e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 9 të Marrëveshjes së BEDZ-it.

3. Të takohen periodikisht për të konsideruar tendencat e krimit transnacional në rajon, në mënyrë që të identifikojnë forma të reja bashkëpunimi ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare të BEDZ-it.

4. T'u raportojnë dhe t'u propozojnë organeve respektive mënyrat për të çuar më tej bashkëpunimin.

5. Të lehtësojnë shkëmbimin e dokumenteve legjislativë dhe të përvojës praktike ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare të BEDZ-it në fushën e luftës ndaj krimit transnacional.

Neni 4

Statusi i Rrjetit brenda BEDZ-it

Rrjeti është një grup bashkëpunimi në fushën e luftës ndaj krimit, i ngritur në përputhje me dispozitat e nenit 6 të Marrëveshjes së BEDZ-it.

Neni 5

Vendi i takimeve të Rrjetit

Rrjeti do t'i zhvillojë takimet në premiset e Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it, përveçse kur vendoset ndryshe me nismën e Kryetarit të radhës së BEDZ-it.

Neni 6

Organizimi dhe operimi

1. Rrjeti do të operojë në përputhje me Kartën, rregullat e procedurave të BEDZ-it, sikurse edhe me dispozitat e Marrëveshjes së BEDZ-it.

2. Secili shtet anëtar i BEDZ-it, Palë në këtë Protokoll shtesë, do të caktojë një oficer ndërlidhës dhe zëvendësin e tij/saj në Rrjet.

3. Për të caktuar ose tërhequr oficerët ndërlidhës në rrjet, Palët do të njoftojnë Sekretariatin e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it, në mënyrë që të informojë të gjitha shtetet anëtare.

4. Rrjeti do të mbledhet periodikisht, të paktën një herë në vit.

5. Rrjeti do të përmbushë detyrat e tij në varësi të grupit të punës për bashkëpunim në luftën ndaj krimit, veçanërisht ndaj formave të organizuara të tij dhe t'i raportojë atij.

Neni 7

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet e oficerëve ndërlidhës, që lidhen me dispozitat e këtij Protokoll shtesë, do të përballohen nga Pala dërguese.

Neni 8

Pikat kombëtare të kontaktit

Palët do të përcaktojnë një pikë kombëtare kontakti brenda autoriteteve të tyre kombëtare të zbatimit të ligjit dhe është e preferueshme të trajtojnë bashkëpunimin ndërkombëtar (Interpol, Qendra e Nismës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SECI) për luftën ndaj krimit ndërkufitar etj.).

Neni 9

Mbrojtja e informacioneve dhe e të dhënave personale

1. Informacioni, që do të sigurohet në kuadër të këtij Protokoll shtesë, do të trajtohet me të njëjtën shkallë konfidencialiteti nga autoriteti kërkuar që aplikon për të tillë informacion në ruajtje.

2. Pa paragjykim ndaj angazhimeve të tjera ndërkombëtare, që kanë lidhje me këtë çështje të shteteve anëtare të BEDZ-it, Palë të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe të këtij Protokoll shtesë, të dhënat personale të marra në kuadër të këtij Protokoll shtesë do të kenë një mbrojtje të paktën ekuivalente me atë të realizuar nga Pala dhënëse.

Neni 10

Vëzhgues dhe të ftuar

1. Përfaqësues të shteteve vëzhguese të BEDZ-it mund të marrin pjesë në punën e Rrjetit, në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurat e BEDZ-it.

2. Institucionet ose agjencitë ndërkombëtare mund të ftohen në takimet e Rrjetit.

Neni 11

Dispozitat e fundit

1. Ky Protokoll shtesë do të jetë i hapur për t'u firmosur ose për të marrë pjesë nga çdo shtet anëtar i BEDZ-it.

2. Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar i BEDZ-it do të jetë depozituesi i këtij Protokoll shtesë. Një kopje e origjinalit të këtij Protokoll shtesë në gjuhën angleze do të depozitohet në Sekretariatit e Përhershëm Ndërkombëtar, i cili do t'i transmetojë një kopje të noterizuar secilës Palë.

3. Ky Protokoll shtesë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur dokumenti i tretë i ratifikimit ose i miratimit është depozituar në Sekretariatit e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it.

4. Për secilën Palë që ratifikon ose miraton këtë Protokoll shtesë, pas depozitimit të dokumentit të tretë të ratifikimit ose miratimit, ky Protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit ose të miratimit nga kjo Palë.

5. Secila Palë mund të tërhiqet nga ky Protokoll shtesë duke njoftuar formalisht Sekretariatit e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it. Tërheqja do të hyjë në fuqi brenda tre muajve pas datës kur njoftimi për tërheqje është marrë nga Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar.

6. Secila Palë mund të propozojë amendamente të këtij Protokoll shtesë. Amendamentet do të pranohen me miratimin e të gjitha Palëve dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 e 4 të këtij neni.

7. Dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll shtesë, Palët do të vazhdojnë me një shqyrtim provizor të rezultateve, që ka dhënë zbatimi i dispozitave të këtij Protokoll shtesë. Një vlerësim përfundimtar do të bëhet brenda 4 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi, me qëllim që të bihet dakord për masat e nevojshme për të përmirësuar më tej bashkëpunimin.

Bërë në Kiev, më 15.3.2002.

V E N D I M

Nr.550, datë 1.8.2003

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 67 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e shërbimeve, që kryhen nga zyrat e gjendjes civile, të jenë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
 2. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve të gjendjes civile të arkëtohen nga organet e qeverisjes vendore dhe të derdhen në Buxhetin e Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare në datën 1.1.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE

Nr.	Lloji i shërbimit	Lekë
1.	Transferimi i të dhënave të gjendjes civile nga zyra e gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm në atë të vendbanimit të ri (me përjashtim të rasteve të transferimit brenda bashkisë ose komunës)	1.000
2.	Veprime për ndarje dhe bashkime familjare të shtetasve	200
3.	Lëshim leje për lidhje martese	300

V E N D I M Nr.22, datë 25.7.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci Anëtar i “““
Alfred Karamuço Anëtar i “““
Kristofor Peçi Anëtar i “““
Kujtim Puto Anëtar i “““
Xhezair Zaganjori Anëtar i “““
Petril Plloçi Anëtar i “““
Sokol Sadushi Anëtar i “““
Gjergj Sauli Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 9.6.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25 Akti që i përket:

KËRKUES: RRAPUSH HOXHA, përfaqësuar nga avokatët Evelina Qirjako e Vangjel Kosta, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. ARTUR BANO, në mungesë.

2. BASHKIA E QYTETIT VLORE, përfaqësuar zoti Vaso Strakosha, me autorizim.

3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE VLORE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1215, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42 dhe 131/f të Kushtetutës

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka realizuar një proces jo të rregullt ligjor sepse vendimin e ka dhënë mbi bazën e rivlerësimit të provave të administruara nga gjykata e faktit, duke tejkaluar kompetencat e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile;

- Me këtë vendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e “gjykatës kompetente”, të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe në nenin 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;

- Kolegji civil, duke tejkaluar kompetencat ka cënuar parimin e “paanësisë” sepse i ka vënë palët në pozita të pabarabarta gjatë shqyrtimit të çështjes. Ai ka cenuar njëkohësisht edhe parimin e ndarjes së pushteteve sepse ka zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes tej atyre të parashikuara nga pushteti legjislativ.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Nga materialet e ndodhura në dosje rezultojnë se kërkuesit Rrapush Hoxha, me vendim nr.90, datë 18.10.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qytetit Vlorë, i është dhënë për kompensim një truall prej 3492 m2 në lagjen “Partizani”. Nga sipërfaqja e këtij trualli, Bashkia e qytetit Vlorë i ka dhënë subjektit të interesuar Artur Bano, 1600 m2 me qira njëvjeçare, për ta përdorur si terren sportiv.

Kërkuesi, me cilësinë e paditësit, ka kërkuar gjyqësisht detyrimin e subjekteve të interesuara që t’i dorëzojnë truallin e dhënë për kompensim prej komisionit, si dhe pushimin e cenimit të pronësisë mbi këtë truall. Në përgjigje të padisë, subjektet e interesuara, kanë paraqitur në gjykatë kundërpadinë e tyre me të cilën kanë kërkuar anulimin e vendimit nr.90, datë 18.10.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.445, datë 12.5.1999, ka vendosur detyrimin e të paditurve që t’i lirojnë dhe dorëzojnë kërkuesit sipërfaqen e truallit prej 1600 m2, rrëzimin e padisë për cenimin e pronësisë dhe rrëzimin e kundërpadisë për anulimin e vendimit nr.90, datë 18.10.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.229, datë 12.5.2000.

Në bazë të rekursit të paraqitur nga Bashkia Vlorë, me cilësinë e palës së paditur, kundërpaditëse, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1215, datë 13.11.2001, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë.

Gjykata Kushtetuese, pas analizës së shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1215, datë 13.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi duhet rrëzuar.

Sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Lartë, shqyrton kurse për vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe gjykata e rrethit, në rastet që parashikohen në këtë Kod. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, rezultojnë se në të janë përcaktuar në mënyrë taksative rastet kur vihet në lëvizje Gjykata e Lartë. Kërkuesi me kërkesën e paraqitur Gjykatës Kushtetuese, pretendon se për çështjen në gjykim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka shqyrtuar rekursin jashtë këtyre rasteve.

Sipas kërkuesit, Kolegji ka tejkaluar kompetencat e veta sepse ka bërë rivlerësimin e fakteve të administruara nga gjykatat, duke e quajtur të zënë truallin e dhënë për kompensim, për shkak se ai “... figuron në hartat e urbanistikës si shesh sportiv ...” dhe se “... është përdorur si terren sportiv që

para çlirimit të vendit ...”.

Për këtë rivlerësim të fakteve që ka sjellë ndryshimin e vendimeve të gjykatave, kërkuiesi pretendon se Kolegji Civil ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, duke shkelur parimin e “gjykatës kompetente”, të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; parimin e “paanësisë” si dhe parimin e “ndarjes së pushteteve”, duke zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes tej atyre të parashikuara nga pushteti legjislativ.

Në kundërshtim me pretendimet e kërkuiesit, Gjykata Kushtetuese çmon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk ka tejkaluar kompetencat e caktuara në ligjin procedural, por ka shqyrtuar bazueshmërinë në ligj të vendimeve të ankimuara me rekurs, gjë që është në funksion të saj si Gjykatë e Lartë.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e quajtur truallin e dhënë për kompensim kërkuiesit si terren sportiv dhe duke e vlerësuar këtë fakt si të njohur botërisht si të tillë, në thelb nuk ka arritur në konkluzione të kundërta. Arsyeja është se ky fakt nuk është kontestuar asnjëherë prej palëve në gjykim, pasi dihej që trualli kishte një destinacion të tillë. Gjykata Kushtetuese çmon se Kolegji Civil nuk ka tejkaluar kompetecat e veta edhe kur truallin e ka quajtur të zënë. Ai, duke konstatuar se terreni sportiv është truall i zënë për qëllime publike, ka bërë vlerësimin juridik të këtij fakti në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në ushtrim të kompetencave të veta ka shqyrtuar bazën ligjore të vendimit të dhënë nga gjykata e rrethit dhe nga ajo e apelit dhe i ka gjetur këto vendime të paligjshme. Paligjshmëria e këtyre vendimeve konsiston në faktin se nga gjykatat, është quajtur e bazuar kërkesë padia e kërkuiesit dhe është vlerësuar i ligjshëm vendimi nr.90, datë 18.10.1995 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në kushtet, kur ky vendim, është marrë në kundërshtim me ligjin “Për kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-Pronarëve” dhe me kërkesat e pikës 6 të vendimit nr.301, datë 14.6.1993 të Këshillit të Ministrave, marrë në zbatim të këtij ligji.

Sipas kësaj pike të vendimit, organi kompetent për të caktuar zona me truall të lirë për kompensim është Seksioni i Urbanistikës së rrethit Vlorë, kurse trualli që iu dha kërkuiesit nuk ishte përcaktuar si truall i lirë për kompensim nga ky organ.

Vendimi i komisionit, është vlerësuar nga kolegji civil se është marrë në kundërshtim me ligjin edhe për faktin se kryetar i tij ka qenë vetë kërkuiesi, i cili për konflikt interesash nuk duhet të merrte pjesë në mbledhjen e komisionit, ku shqyrtohej çështja e tij.

Nisur nga argumentet e parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon përfundimisht se për çështjen në gjykim, nuk u vërtetua të jetë zhvilluar procesi i parregullt ligjor i pretenduar nga kërkuiesi dhe se nuk janë shkelur parimet kushtetuese të pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr.23, datë 25.7.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija VuciAnëtar i““
Gjergj SauliAnëtar i““
Alfred KaramuçoAnëtar i““
Kristofor PeçiAnëtar i““
Xhezair ZaganjoriAnëtar i““
Sokol SadushiAnëtar i““
Kujtim PutoAnëtar i““

me sekretare Arbenka Lalica, më datat 30.4.2003, 3.6.2003 dhe 9.6.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.22 Akti që i përket:

KËRKUES: MYSTEHAK RAMA, përfaqësuar nga avokat Remzi Kruja, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. NAZMIË SEDARI, FJORILDA SEDARI, përfaqësuar nga Xhezmi Sedari, me prokurë.

2. XHEZMI SEDARI, përfaqësuar nga avokat Aldo Zadrime, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.523, datë 3.5.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.512, datë 3.5.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të lartpërmendura:

- Gjykata e apelit nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor sepse nuk ka respektuar asnjë nga detyrat e vëna nga Gjykata e Lartë dhe ka cënuar rëndë interesat e tij;

- Gjykata e apelit refuzoi kërkesën për çeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave në kundërshtim me kërkesat e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duhet të respektonte vendimin e tij të mëparshëm për marrjen e provave dhe për zgjerimin e hetimit gjyqësor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.782, datë 16.3.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarit Mystehak Rama, ngritur kundër subjekteve të interesuara Xhezmi, Nazmie e Fjorilda Sedari, për njohjen bashkëpronarë mbi një shtëpi banimi. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.820, datë 3.6.1999, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe e ka njohur kërkuarin bashkëpronar. Mbi ankimin e subjekteve të interesuara, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1042, datë 12.10.2000, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim me arsyetimin se vetëm jetesa e përbashkët, nuk është e mjaftueshme për të pranuar që palët e kanë ndërtuar shtëpinë për të qenë bashkëpronarë mbi të dhe se gjykatat duhet të shqyrtonin, nëse ndërmjet palëve ka pasur ndonjë marrëveshje për krijimin e bashkëpronësisë.

Në rigjykim, gjykata e apelit, nuk ka pranuar kërkesën e kërkuarit për të riçelur hetimin gjyqësor e për të pyetur dëshmitarët e paraqitur prej tij me arsyetimin se çështja është e sqaruar në gjykimet e mëparshme dhe se vetë pohimet e paditësit e provat shkresore të administruara, krijojnë bindjen se nuk ka pasur marrëveshje bashkëpronësie ndërmjet palëve.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.1042, datë 12.10.2000, ka dhënë disa udhëzime, të cilat, sipas nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile, ishin të detyrueshme për gjykatën e apelit. Por, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuari, kjo gjykatë në rigjykimin e çështjes nuk ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës. Gjykata e apelit i është përmbajtur udhëzimeve të Gjykatës së Lartë si për interpretimin e ligjit, ashtu dhe për vlerësimin e provave pa cenuar parimet kushtetuese të procesit gjyqësor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka

vënë detyra konkrete për marrjen e provave, por se gjykata e apelit ka bërë vlerësimin e provave të ndodhura në dosje, si ato me shkrim, ashtu dhe me dëshmitarë. Pas këtij vlerësimi ajo arriti në përfundimin që provat e ndodhura në dosje, sidomos ato me shkrim së bashku me pohimet e vetë kërkuarit, vërtetimin se nuk kishte marrëveshje për krijimin e bashkëpronësisë në shtëpinë e banimit.

Gjithashtu gjykata e apelit nuk i ka vënë palët në kushte pabarazie, qoftë përsa i përket paraqitjes së provave në proces, qoftë përsa i përket zbatimit të parimit procedural të kontradiktoritetit. Në gjykimet e mëparshme, gjykata u ka dhënë mundësi të dy palëve të paraqesin provat, të cilat janë vlerësuar edhe në rigjykimin në gjykatën e apelit. Kjo e fundit e ka mbështetur vendimin e saj në shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të sjella nga palët, për të cilat këto të fundit kanë debatuar duke shprehur opinionet e prapësimet e tyre pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa iu mohuar ndonjë e drejtë që lidhet me cenimin e së drejtës së mbrojtjes në kuptimin kushtetues. Nëse gjykata e apelit çmoi që nuk është e nevojshme marrja e provave të tjera me dëshmitarë, nuk do të thotë se i ka mohuar kërkuarit të drejtën e mbrojtjes. Nga arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit del se arsyeja e mosmarrjes së provave me dëshmitarë në rigjykim nuk kishte të bënte me cenimin e parimit të barazisë së armëve, por me vlerësimin dhe rëndësinë e tyre nga këndvështrimi i zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Gjykata Kushtetuese nuk gjen elementë të procesit jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues edhe në vendimin nr.512, datë 3.5.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhënë në dhomën e këshillimit. Ky kolegji, sipas kompetencave të veta, ka arritur në përfundimin se nuk ka shkaqe për për kalimin e çështjes në gjyq, duke u bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile pas shqyrtimit të shkaqeve të parashtruara në rekurs dhe dokumentacionit të dosjes. Nga ana tjetër, jo çdo moszbatim detyrë përbën proces jo të rregullt në kuptimin kushtetues, aq më tepër që vetë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar si janë zbatuar detyrat e veta kur vendosi moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës;
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me mendimin e shumicës. Vendimi nr.523, datë 3.5.2001 i Gjykatës së Apelit Tiranë, është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë ai duhet shfuqizuar si antikushtetues.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke prishur vendimin e mëparshëm të gjykatës së apelit, krahas orientimeve për vlerësimin e bashkëpronësisë ndërmjet palëve, ka pranuar se regjistrimi i shtëpisë në pronësi të të paditurit Xhezmi Sedari “është i pavlefshëm, sepse është bërë mbi bazën e një vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit të ndërtimit”. Duke e konsideruar të pavlefshëm këtë regjistrim dhe duke pranuar se “gjykatat duhet të shqyrtonin, nëse ndërmjet palëve ka pasur ndonjë marrëveshje për krijimin e bashkëpronësisë”, Gjykata e Lartë orienton që duhet të merren provat e reja.

Qëndrimi i gjykatës së apelit është antikushtetues, sepse ajo jo vetëm nuk ka zbatuar këto detyra që në fakt përbëjnë shkakun e dërgimit për rigjykim, por i ka mohuar njërës palë të drejtën e paraqitjes së provave. Marrja e këtyre provave mund t'i jepte drejtim tjetër zgjidhjes së çështjes. Në këtë mënyrë ajo ka vepruar në kundërshtim me nenet 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit udhëzimet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen.

Barazia e armëve dhe e shanseve dhe parimi i kontradiktoritetit janë elemente të procesit të rregullt ligjor edhe në kuptimin kushtetues. Prandaj, gjykata e apelit kishte detyrë të krijonte mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e palëve dhe për të drejtën për të paraqitur provat, aq më tepër që kjo ishte vënë si detyrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në të vërtetë në gjykimin në apel jo vetëm që kërkuesit iu mohua kjo e drejtë që kishte të bënte drejtpërdrejt me mbrojtjen e tij në gjyq, por ashtu siç veproi gjykata, kërkuesi e ndjeu veten në pozita të disfavorshme përballë kundërshtarit të tij.

A N Ë T A R
K. Puto

V E N D I M
Nr.24,datë 30.7.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli Anëtar i “““
Alfred Karamuço Anëtar i “““
Kristofor Peçi Anëtar i “““
Kujtim Puto Anëtar i “““
Xhezair Zaganjori Anëtar i “““
Petril Plloçi Anëtar i “““
Sokol Sadushi Anëtar i “““
Zija Vuci Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.4.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.23 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MIRDITË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë
2. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zotërinjtë Ilir Shurdhi e Gëzim Veleshnja, këshilltarë të Departamentit Juridik, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 375 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”

BAZA LIGJORE: Neni 145/2 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë

Kërkuesi ka parashtruar se kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Penale, vjen në kundërshtim me nenin 31 shkronjat “a” e “b” të Kushtetutës. Mënyra e formulimit të saj nuk i krijon mundësi të pandehurit të njihet hollësisht me përcaktimin e ri të faktit të bërë nga gjykata, nuk i lë atij kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe për ta ndërtuar atë në përshtatje me ndryshimin e akuzës. Pozita e tij rëndohet veçanërisht kur ky ndryshim shoqërohet me zbatimin e një ligji material, që përmban dënim më të rëndë, sepse gjykata, pas diskutimit përfundimtar të palëve, nuk ka të drejtë të riçelë seancën gjyqësore.

Në këto rrethana, kërkuesi duke cituar edhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.50, datë 30.7.1999, kërkon shfuqizimin e dispozitës së lartpërmendur të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, pas mbylljes së hetimit gjyqësor dhe diskutimeve përfundimtare, është tërhequr në dhomën e bisedimeve dhe ka vendosur pezullimin e gjykimit për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Llesh Mark Lekëgegaj. Në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, kjo gjykatë, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin si antikushtetues të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, duke çmuar se kjo dispozitë, vjen në kundërshtim me nenin 31 shkronjat “a” e “b” të Kushtetutës.

Ushtrimin e kësaj kërkesë gjykata e ka argumentuar me nevojën që i ka lindur në këtë fazë gjykimi, për të ndryshuar cilësimin juridik të njëres prej veprave që i atribuohen të pandehurit.

Organi procedues në kërkesën e tij për gjykim, e ka cilësuar atë si vrasje me paramendim në dëm të dy personave, të mbetur në fazën e tentativës. Mbi këtë bazë, ai ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zbatohet dy herë neni 78 në kombinim me nenin 25 të Kodit Penal. Cilësimin ligjor të kësaj veprë, gjykata e ka vënë në dyshim dhe ka biseduar mbi nevojën për t’i dhënë këtij fakti një përcaktim tjetër juridik.

Për ta realizuar këtë, gjykata i është referuar nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, ka bërë interpretimin e përmbajtjes së tij dhe ka dalë me konkluzionin se për shkak të ndryshimeve që ka pësuar kjo dispozitë, asaj si gjykatë e shkallës së parë, pas tërheqjes në dhomën e bisedimeve, i lejohet që këtë problem juridik ta zgjidhë vetëm me vendim përfundimtar, se nuk ka të drejtë të dalë me vendim të ndërmjetëm, të riçelë seancën gjyqësore për t’u komunikuar palëve ndryshimin e cilësimit juridik të veprës dhe të dëgjojë pretendimet e tyre. Këto ndalesa, sipas gjykatës, rëndojnë pozitën e të pandehurit për shkak se këtij i hiqet mundësia të njihet hollësisht me akuzën e re të ndryshuar dhe nuk i sigurohen koha e lehtësitë e mjaftueshme për të organizuar e realizuar mbrojtjen.

Në radhë të parë, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të sqarojë se shqyrtimi i kësaj çështje, sipas objektit të lartpërmendur nuk ka lidhje me vendimin e saj nr.50, datë 30.7.1999. Kjo, për arsye se shkaqet e parashtruara në këtë kërkesë janë krejt të ndryshme, ndërsa dispozita objekt i këtij gjykimi ka pësuar ndryshime thelbësore me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002.

Duke e parë çështjen në dritën e këtyre ndryshimeve, si dhe të pretendimeve të parashtruara, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, është e pabazuar.

Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet me këto argumente dhe ripohon se gjykata e zakonshme nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur bën cilësimin e duhur ligjor të veprës duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, ajo bën interpretimin e ligjit që zbaton, gjë që është në kompetencën e saj. Pozita e të pandehurit nuk rëndohet edhe kur cilësimi i ri i veprës është më i rëndë, sepse rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjykimit. Në zgjidhjen e çështjeve konkrete, gjykata e zakonshme, ushtron funksionin e saj juridiksional, sqaron kuptimin e ligjit që duhet të zbatohet, me qëllim që të eliminojë çdo dyshim që lidhet me cilësimin juridik të veprës, për të siguruar kështu stabilitetin e së drejtës dhe rivendosjen e rendit juridik të shkelur.

Siç u tha edhe më lart, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, ka pësuar ndryshime. Fjalët “duke vënë në dijeni palët” si detyrim për gjykatën nuk figurojnë më në formulimin e ri të kësaj dispozite. Ky ndryshim nuk sjell si pasojë papajtueshmërinë e kësaj dispozite, me nenin 31 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese çmon se dalja e gjykatës në seancë gjyqësore dhe vënia në dijeni e palëve për mënyrën e zgjidhjes së këtij problemi ligjor, pa u shprehur kjo më parë me vendim përfundimtar, mund t’i krijojë atyre dyshime për paragjykimin e çështjes nga ana e saj, gjë që mund të shoqërohet me një shkelje tjetër kushtetuese që lidhet me mosrespektimin e së drejtës themelore të individit për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanëshme.

Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet as me konkluzionet e tjera të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Mirditë. Në kërkesën e saj ajo ka parashtruar si argumente për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale edhe përmbajtjet e neneve 372, 373 e 374 të këtij Kodi, ndonëse nuk ekziston ndonjë lidhje midis tyre. Kjo për arsye se këto të fundit parashikojnë rastet kur

ndryshon fakti që përmendet në kërkesën për gjykim, d.m.th., kur gjatë procesit gjyqësor dalin vepra penale ose rrethana të reja në ngarkim të të pandehurit. Shqyrtimi i këtyre veprave së bashku me akuzën fillestare në një proces të vetëm, nuk mund të vendoset kryesisht nga gjykata, por vetëm me kërkesën e prokurorit dhe në rastin e daljes së një fakti të ri, edhe me pëlqimin e të pandehurit.

Në dallim nga kjo, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon rastet kur fakti që i atribuohet të pandehurit nuk ndryshon dhe mbetet i njëjtë deri në momentin e tërheqjes së gjykatës në dhomën e bisedimeve.

Në një rast të tillë, është gjykata ajo që çmon dhe vendos kryesisht për t'i dhënë këtij fakti një përcaktim tjetër, të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI PARALEL

Ashtu si shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, jam edhe unë për rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, por me tjetër arsyetim.

Neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, nuk ka lidhje dhe nuk i bëhej pengesë kësaj të fundit për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 20.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ajo nuk duhej të pezullonte gjykimin dhe t'i kërkonte Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dispozitës objekt kërkesë.

Ky konkluzion imi gjen mbështetje të plotë në materialin që ndodhet në dosjen gjyqësore të krijuar nga vetë kjo Gjykatë e zakonshme. Nga aktet del se nevoja për ndryshimin e cilësimit të veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë në dëm të dy personave e kryer kjo nga i pandehuri Llesh Mark Lekëgegaj, asaj nuk i ka lindur pas tërheqjes në dhomën e bisedimeve. Përkundrazi, vetë prokurori që ka marrë pjesë në gjyq, në datën 14.2.2003, ka kërkuar i pari që këtij fakti t'i jepet një përcaktim tjetër, i ndryshëm nga ai që ka bërë organi procedues në kërkesën e tij për gjykim.

Mbi kërkesën e avokatit të të pandehurit, gjykata ka vendosur shtyrjen e gjykimit për në një ditë tjetër, për të hetuar gjendjen mendore të këtij të fundit. Pasi kjo detyrë është kryer nga ekspertët, seanca e fundit ku janë shqyrtuar konkluzionet e tyre dhe është mbyllur hetimi gjyqësor, është zhvilluar në datën 17.2.2003. Përsëri gjykimi është shtyrë për t'i dhënë palëve kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.

Në datën 14.1.2003, është çelur seanca gjyqësore për të dëgjuar konkluzionet përfundimtare të palëve. Si prokurori, ashtu edhe avokati i të pandehurit janë shprehur për ndryshimin e cilësimit ligjor të kësaj vepre, por secili ka kërkuar që ky ndryshim të realizohet duke zbatuar dispozita të ndryshme të ligjit material; prokurori nenin 79 shkronja “dh”, ndërsa mbrojtësi i të pandehurit dy herë nenin 76 të Kodit Penal. Pra, në rastin konkret, të pandehurit i janë siguruar të drejtat që parashikohen në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 31 të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, me pretendimin se ky përbën shkak për shkeljen e këtyre të drejtave, në fakt nuk qëndron dhe si i tillë duhet rrëzuar.

A N Ë T A R I

Z. Vuci

V E N D I M
Nr.25,datë 30.7.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci Anëtar i“““

Gjergj Sauli Anëtar i“““

Alfred Karamuço Anëtar i“““

Kristofor Peçi Anëtar i“““

Kujtim Puto Anëtar i“““

Petrit Plloçi Anëtar i“““

Sokol Sadushi Anëtar i“““

Xhezair Zaganjori Anëtar i“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 10.6.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti që i përket:

KËRKUES: KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar nga zoti Njazi Jaho, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 437 pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 483 paragrafi i dytë dhe pjesërisht paragrafi i tretë të Kodit të Procedurës Civile.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/c, 33/1, 42 dhe 131/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitave të mësipërme, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe:

- Formulimet e dispozitave që kontestohen u mohojnë respektivisht të pandehurve dhe palëve në proces të drejtën themelore kushtetuese që të mbrohen vetë.

- Ato bien në kundërshtim me nenet 31/c dhe 33/1 të Kushtetutës, ku thuhet se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë “të mbrohet vetë...”, dhe se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet përpara se të gjykohet”, si dhe me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me nenin 14/3 c të “Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”.

- Gjykata e Lartë nuk i lejon të pandehurit dhe palët të mbrohen vetë në gjykimet që zhvillohen pranë kësaj gjykate.

- E drejta për t’u mbrojtur vetë nuk mund të kufizohet me ligj.

- Shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga veçoritë e saj, konsiderohet proces gjyqësor. Si rrjedhim, edhe në këtë rast, zbatohen parimet e njohura të publicitetit, të mbrojtjes vetë, të “barazisë së armëve”, të paanësisë dhe objektivitetit, etj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesit dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Në kërkesën e paraqitur, Komiteti Shqiptar i Helsinkit pretendon se pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe paragrafi 2 dhe pjesërisht paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Civile janë antikushtetuese dhe si të tillë duhet të shfuqizohen, pasi nga përmbajtja e tyre del qartë që të pandehurit dhe palëve në procesin civil u mohohet e drejta kushtetuese për t'u mbrojtur vetë në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Sipas kërkesës, një e drejtë e tillë themelore garantohet nga përmbajtja e nenit 31 germa "c" (Në procesin penal kushdo ka të drejtë "të mbrohet vetë ...), nenit 33 pika 1 ("Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet") dhe nenit 42 ("Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik ..."), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (E drejta për një proces të rregullt), dhe neni 14/3c të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Gjykata Kushtetuese konstaton se dispozitat që përbëjnë objektin e kërkesës nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, prandaj kërkesa e paraqitur duhet të rrëzohet si e pabazuar për këto arsye:

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit ka prioritet në shtetin demokratik. Shteti i së drejtës, kuadri ligjor në tërësi dhe institucionet që ngrihen mbi këtë bazë kanë si synim dhe objektiv kryesor, pikërisht, garantimin dhe mbrojtjen sa më mirë dhe sa më efektive të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Kjo është në qendër të vëmendjes së gjithë mekanizmave që organizohen dhe funksionojnë në kuadër të të tre pushteteve, por duke bërë një ndarje të qartë të rolit dhe detyrave që realizon në këtë drejtim secili prej tyre.

Këto kërkesa kanë gjetur pasqyrim në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në përgjithësi në kuadrin ligjor të vendit tonë. Kështu ka ndodhur edhe kur bëhet fjalë për kompetencat, mënyrën e organizimit dhe të veprimtarisë së Gjykatës së Lartë si autoriteti më i lartë gjyqësor përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe njësimin e ndryshimin e praktikës gjyqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese thekson se shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë ka karakter të veçantë. Ajo nuk përsërit gjykimet e zhvilluara për të njëjtën çështje në shkallë të parë ose edhe në gjykatën e apelit, pra nuk e trajton çështjen edhe nga pikëpamja e faktit, por kufizohet kryesisht në çështjet ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga këto gjykata. Gjykata e Lartë kontrollon nëse në gjykimet e zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit janë zbatuar ose jo kërkesat e ligjit.

Në nenin 141 të Kushtetutës thuhet shprehimisht ndër të tjera se: "Gjykata e Lartë ka juridikson ... rishikues". Pavarësisht nga mungesa e dispozitave të tjera që do ta qartësonin më tej juridiksionin e Gjykatës së Lartë, vlerësohet se në nocionin kushtetues të rishikimit futet në radhë të parë shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes së ligjit material ose procedural, që në fakt përbën edhe funksionin qendror të Gjykatës së Lartë, si dhe rishikimi në kuptimin klasik, që do të thotë shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë edhe për gabim në fakt, pra për bazueshmërinë në prova të vendimit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit.

Ndryshe qëndron problemi në rastet e trajtimit të kërkesave në formën e rekursit. Sipas Kodeve të Procedurës Penale dhe Civile, respektivisht nenet 432 dhe 472, një recurs i tillë në Gjykatën e Lartë mund të bëhet vetëm: a) për mosrespektim apo zbatim të gabuar të ligjit; b) për shkelje të rënda të normave procedurale (Kodi i Procedurës Penale) ose të tilla që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës (Kodi i Procedurës Civile) dhe c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Pra, në të tre rastet, bëhet fjalë për zbatim të gabuar ose shkelje të ligjit material ose procedural.

Përsa më sipër, në Gjykatën e Lartë edhe vetë rishikimi mbi bazën e rekursit është i një lloji të veçantë. Kërkesa trajtohet fillimisht në Dhomën e Këshillimit me 5 gjyqtarë, pa pjesëmarrjen e të pandehurit, palëve apo mbrojtësve të tyre. Nëse shkaqet e paraqitura janë në përputhje me ato që lejon ligji, vendoset pranimi i kërkesës dhe kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, në të kundërt, vendoset që në këtë fazë mospranimi i rekursit (neni 433 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 480 i Kodit të Procedurës Civile).

Kur çështja kalon në seancë gjyqësore zbatohen parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Në funksion të sigurimit të një mbrojtje sa më efektive, vetë specifika e trajtimit të çështjes në këtë fazë

në Gjykatën e Lartë imponon disa veçanti. Problemet që shtrohen aty kanë karakter të mirëfilltë ligjor, prandaj diskutimi i tyre kërkon përgatitje dhe nivel të lartë profesional. Në emër të të pandehurit apo palëve në gjykim, një gjë të tillë mund ta realizojë me profesionalizëm avokati i tyre. Ai i ka të gjitha mundësitë dhe aftësitë për të mbrojtur realisht dhe me efikasitet përpara Gjykatës së Lartë interesat e subjektit që përfaqëson. Pikërisht për këto arsye, ka raste që edhe nga këndvështrimi formal, vende të ndryshme ofrojnë zgjidhje të ngjashme me atë të vendit tonë e procesi në Gjykatën e Lartë quhet edhe si “Procesi i Avokatit”.¹ Për më tepër dhe në funksion të kësaj specifike të trajtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, në shumë vende, të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit apo palëve pranë kësaj Gjykate, e ka një numër i kufizuar avokatësh që zgjidhen sipas kritereve të përcaktuara rigorozisht në ligj, mes të cilave vëmendje e veçantë i kushtohet përgatitjes profesionale.

Një mbrojtje e tillë me avokat është nga ana tjetër edhe në interes dhe në funksion të kërkesave të shtetit të së drejtës, pasi i shërben më mirë krijimit të sigurisë juridike dhe dhënies së drejtësisë në përgjithësi, për të cilat një rol tepër të spikatur Kushtetuta jonë i ngarkon Gjykatës së Lartë. Mbrojtja objektive e të drejtave dhe lirive themelore ka prioritet dhe rëndësi të veçantë në Gjykatën e Lartë. Përmes kësaj mbrojtje bëhet njëkohësisht edhe njësimi i praktikës gjyqësore, zbatimi i drejtë dhe i njëlojtë i ligjit, si dhe vetë garantimi i të drejtave dhe lirive individuale.

Në nenin 31/c të Kushtetutës thuhet se në procesin penal kushdo ka të drejtë “të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij...”, ndërsa në nenin 33/1, duke iu referuar sërish procesit penal, deklarohet se: “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet”. Në këtë mënyrë deklarohet një e drejtë kushtetuese me rëndësi thelbësore, e drejta e të pandehurit për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur vetë ndaj akuzës së bërë ndaj tij. Pjesëmarrja e të pandehurit në seancë gjyqësore dhe mundësia e mbrojtjes vetë janë padyshim elemente të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, deklarimet e të pandehurit në seancë, pavarësisht se ai mund të mbrohet njëkohësisht dhe nga një avokat, i shërbejnë vetë gjykimit të çështjes. Ato shërbejnë për të saktësuar e sqaruar më mirë mjaft elemente të veprës penale, si rrethanat e kryerjes së saj, motivet, formën dhe shkallën e fajësisë të cilat, marrë në tërësi, do të ndikojnë dukshëm edhe në fatin e akuzës, kualifikimin e veprës, si dhe llojin dhe masën e dënimit.

Parimet e pjesëmarrjes dhe të mbrojtjes vetë të palëve kanë rëndësi edhe në proceset civile, pavarësisht se në këto procese, për vetë natyrën e tyre, si rregull palët përfaqësohen që në fillim me avokat. Sidoqoftë, në gjykime të posaçme, deklarimet e palëve edhe në procesin civil në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, marrin rëndësi të dorës së parë për vetë procesin. Jo vetëm kaq, por edhe në procesin civil, sipas nenit 186 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka të drejtë ta thërrasë dhe pyesë palën në gjykim, pasi ajo është, shpeshherë, burimi kryesor i drejtpërdrejtë i fakteve apo rrethanave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.

Mbrojtja vetë është pjesë e rëndësishme e të drejtës së mbrojtjes në kuptimin që jep edhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që garanton të drejtën për proces të rregullt. Në paragrafin e parë të këtij neni thuhet ndër të tjera se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht ...”, ndërsa në paragrafin e tretë pika “c” të po këtij neni, duke iu referuar çështjeve penale, thuhet se çdo i akuzuar ka të drejtë “të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij ...”.

Nga ky këndvështrim, dispozitat që kontestohen nga kërkuesi, konkretisht pikat 3 dhe 5 të nenit 437 të Kodit të Procedurës Penale dhe paragrafet 2 dhe 3 të nenit 483 të Kodit të Procedurës Civile, duke kërkuar që mbrojtja e interesave të të pandehurit dhe palëve në procesin civil në seancën gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë të bëhet me avokat, mund të duket se bien në kundërshtim me nenet 31/c dhe 33/1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata Kushtetuese konstaton se në seancën gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë nuk kemi cenim të parimit të përgjithshëm të mbrojtjes. Përkundrazi, përfaqësimi me avokat në këtë seancë synon garantimin e një mbrojtje sa më efektive dhe sa më profesionale të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Ajo synon mbrojtjen reale të të drejtave të të pandehurit dhe palëve në proces, respektimin e ligjit dhe dhënien e drejtësisë në përgjithësi.

Duke iu referuar të drejtës së mbrojtjes në gjykatën e apelit apo në Gjykatën e Lartë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar disa herë se në këto raste, rëndësi thelbësore ka garantimi i praktikitetit dhe efektshmërisë së kësaj mbrojtje. Në çështjen Airey kundër Irlandës, ajo ka

¹ Në gjuhën gjermane quhet “Anwaltsprozess”

vënë në dukje se: “Konventa synon të garantojë të drejta që nuk janë teorike dhe sipërfaqësore, por të drejta që janë praktike dhe efektive”². Mbi këtë bazë ajo ka konkluduar në mjaft raste se trajtimi nga gjykata respektive, jo i problemeve të faktit, por vetëm i problemeve ligjore, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat, por për më tepër është e domosdoshme për garantimin e një mbrojtje efektive dhe të dobishme, gjithnjë në favor të të pandehurit apo palëve në gjykimin civil.³ Në çështjen Pakelli kundër Gjermanisë, Gjkata Europiane e të Drejtave të Njeriut vë në dukje ndër të tjera se nisur pikërisht nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe fokusimin e saj në çështje të ligjit, se “... pa ndihmën e një avokati ai nuk mund të kontribuonte në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndronin në thelb të mosmarrëveshjeve”.⁴

Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se sipas përcaktimeve që bën Gjkata Europiane e të Drejtave të Njeriut në kuadër të nenit 6 të Konventës, procesi i drejtë për një çështje konkrete konsiderohet i tillë dhe i pandarë që nga shqyrtimi i saj në gjykatën e shkallës së parë e deri në përfundim të gjykimit në instancën e fundit gjyqësore.

Nga ky këndvështrim duhet të evidentohet fakti i rëndësishëm se legjislacioni ynë, mbi bazën e Kushtetutës dhe në përputhje me standardet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, i garanton plotësisht të pandehurit dhe palëve në procesin civil mundësinë e pjesëmarrjes aktive në gjykimet që zhvillohen në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, pra aty ku çështja trajtohet në tërësi si nga pikëpamja faktike, ashtu edhe ajo ligjore. Pavarësisht se interesat e tyre edhe në këto raste mbrohen si rregull me avokat, në këto gjykime ato kanë të drejtën dhe mundësinë të paraqesin dhe kundërshtojnë vetë prova, të bëjnë pyetje dhe të japin vetë sqarime, të shprehen për aspekte të përgjithshme dhe të veçanta të procesit të cilat i vlerësojnë vetë si të rëndësishëm. Gjithçka e deklaruar apo e pretenduar prej tyre pasqyrohet në dosjen gjyqësore, e cila administrohet më pas e plotë edhe në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Në trajtimin e çështjes dhe në vendimin që merr Gjkata e Lartë ka parasysh edhe këto deklarime apo prova, por duke u kufizuar kryesisht në kontrollin e zbatimit të ligjit material ose procedural për çështjen konkrete nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit. Pikërisht, për shkak të kësaj specifike parashikohet që në Gjykatën e Lartë, interesat e të pandehurit dhe të palëve në procesin civil të mbrohen me avokat.

Së fundi, duhet të theksohet se edhe seanca gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë ka karakter publik. Në këtë seancë mund të marrin pjesë edhe palët e interesuara, të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm dhe mund të konsultohen apo mund t'i bëjnë propozime në çdo kohë avokatit të tyre. Avokati është zëri profesional i të përfaqësuarit. Palët nuk mund të jenë protagonistë në seancën që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Ky rol u takon avokatëve të tyre. Krahës të tjerave, protagonizmi i të pandehurit dhe palëve në procesin civil do të sillte në mënyrë të pashmangshme në Gjykatën e Lartë edhe elemente të panevojshëm emocionalë, të cilët natyrshëm do të shkaktonin zvarritje të problemit, si dhe shmangie nga detyra qendrore e kësaj gjykate, që është shqyrtimi i çështjes kryesisht në këndvështrim të zbatimit të saktë të ligjit material dhe procedural.

PËR KËTO ARSYE,

Gjkata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

² Shih Airey kundër Irlandës, në “Për një rend publik evropian”, Tiranë 2001, faqe 517

³ Shih Sutter kundër Zvicrës; Monnelli & Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar; Pakelli kundër Gjermanisë, etj.

⁴ Shih Pakelli kundër Gjermanisë, në “Për një rend publik evropian”, Tiranë 2001, faqe 816

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 11.8.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë